



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenet 4 parag. 1.2 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe nenin 15.2 shkronja d) të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, sipas njoftimit nr. 100/18 të datës 25.05.2018 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë (për nominim të anëtarit të ri në KKS), Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2018, mori,

VENDIM PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Neni 1

Me këtë vendim bëhet zëvendësimi i një anëtari të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe atë:

z.Bekim Jashari, ish kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, për shkak të angazhimit në punë dhe detyra tjera të punës,

zëvendësohet me,

z.Osman Kurtolli, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nr.01-020/04-0038894/18 i datës 11 maj 2018.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-020/04-0050881/18
Podujevë,
29 qershor 2018

